

La vaccination contre la Covid-19 en Wallonie



Vaksinimi kundër COVID-19

- ✓ COVID-19 nuk do të zhduket menjëherë.
- ✓ Në sajë të vaksinës dhe duke vazhduar respektimin e masave sanitare gjithashtu, ne mund të shpresojmë ta lëmë prapa krizën aktuale dhe së shpejti të marrim frymë lirisht.
- ✓ Vaksina ju mbron ju por mbron gjithashtu edhe të tjerët kundër koronavirusit.
- ✓ Vaksina është falas.

Si funksionon vaksina ?


- Në sajë të vaksinës, trupi juaj prodhon antitropa
- Këta antitropa ndihmojnë në luftimin e grimcave të virusit
- Do të jeni në kontakt me virusin më vonë? Në këtë rast, antitropat do t'ju mbrojnë!

Pse është i rëndësishëm vaksinimi ?

Për të mbrojtur veten dhe të tjerët

Koronavirusi është i rrezikshëm për shumë njerëz:

- për njerëzit e moshës nga 65 vjeç e lart
 - për njerëzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërive, të zembrës ose ato vaskulare
 - për njerëzit që vuajnë nga diabeti ose që kanë një sistem imunitar të dobët (p.sh. ata që vuajnë nga kanceri)
- Por virusi mund të jetë i rrezikshëm gjithashtu edhe për të rinjtë dhe njerëzit e shëndetshëm.



Për të luftuar kundër përhapjes së virusit

- Nëse vaksinohet më shumë se 70% e popullsisë belge, virusi do të përhapet më ngadalë. Ky quhet imunitet kolektiv.
- Jeta juaj do të kthehet në normalitet më shpejt.
- Trupi juaj do të jetë më i fortë për të luftuar virusin.



Si bëhet vaksinimi ?

- Ju do të merrni një injeksion në pjesën e sipërme të krahut
- Për disa vakcina, do të merrni një injeksion të dytë disa javë pas vaksinës së parë.
- 14 ditë pas vaksinës, ju do të jeni të mbrojtur mjaftueshëm kundër koronavirusit



A është e sigurt vakcina ?

- Prodhimi i vaksinave kërkon një ekspertizë të madhe. Shkencëtarët në disa vende kanë punuar shumë për të prodhuar vakcina sa më shpejt të jetë e mundur.
- Vakcina është monitoruar në mënyrë rigoroze nga disa autoritete të pavarura. Vakcina është e sigurt.





A shkakton vaksinimi efekte anësore ?

Ju mund të keni ndoshta:

- një skuqje të lehtë të lëkurës, dhimbje ose enjtje në pjesën e sipërme të krahut
- lodhje
- dhimbje koke
- pak ethe (temperaturë)

Kjo është normale dhe nuk ka rëndësi, efektet anësore zhduken pas disa orësh ose ditësh.



Kush do të vaksinohet ?

- Vaksinimi ka të bëjë me të gjithë njerëzit mbi moshën 18 vjeç
- Vaksinimi kundër koronavirusit kryhet me dëshirë dhe është falas për të gjithë
- Vaksina nuk është e detyrueshme

Ftesat :

- Ato dërgohen gradualisht me postë dhe më pas bëhet njoftimi gjithashtu me e-mail ose me mesazh.
- Ftesat shoqërohen nga një pyetësor shëndetësor që duhet plotësuar.
- Ato ofrojnë vendet e vaksinimit dhe specifikojnë se si të caktoni takimin si dhe një kod personal me 16 karaktere.

Marrja e një takimi :

Mund të merrni takim përmes faqes së internetit: www.jemevaccine.be ose përmes telefonit në numrin e mëposhtëm 0800/450 19.

Thirrja është falas.

Për vaksinat e dhëna në 2 doza, duhet t' i merrni të dyja takimet në të njëjtën kohë.

Ju mund ta anuloni takimin dhe të lini një takim të ri me kodin tuaj personal i cili është i vlefshëm për 30 ditë.


Nëse vendet e takimit nuk janë të disponueshme, mos ngurroni të provoni të kontaktoni përsëri më vonë.

DITËN E VAKSINIMIT :

- Duhet të jeni i përpiktë lidhur me orarin e takimit
- Duhet të merrni me vete :
 - kartën e identitetit (është e detyrueshme)
 - ftesën (nëse është e mundur, biletën elektronike)
 - pyetësorin shëndetësor të plotësuar siç duhet



- Pas injeksionit sigurohet një periudhë monitorimi nga 15 deri në 30 minuta
- Mbjajtja e maskës është e detyrueshme
- Ejani vetëm përveç rastit kur keni nevojë për ndihmë për t' u shoqëruar
- Nëse jeni i sëmurë, mos hajdeni dhe merrni një takim tjetër



Pasi të vaksinoheni, vazhdoni të respektoni gjestet pengesë :

Do të jetë e nevojshme të qëndroni të kujdesshëm akoma edhe për një kohë duke respektuar të gjitha masat paraprake të dobishme: (mbajtja e maskës, distanca fizike, higjiena e duarve, ajrosja e mjediseve...), për disa arsye

- ✓ Vaksina nuk ju mbron menjëherë pas marrjes së saj.
- ✓ Popullsia vaksinohet gradualisht, ne nuk jemi të vaksinuar të gjithë në të njëjtën kohë.



Është mirë për ta ditur" - për më shumë informacion: www.jemevaccine.be – thirrja është falas në numrin e mëposhtëm 0800/450 19

Për më shumë informacion, kontaktoni :

- Shërbimet e ndihmës dhe shoqatat lokale aktive të zonës suaj (nëse është e nevojshme, mund të kontaktoni edhe numrin falas 1718).
- Kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj ose në mungesë të kontaktit me mjekun e familjes, kontaktoni numrin si më poshtë vijon: 1733.
- Për organizimin e transportit falas drejt qendrave të vaksinimit: **0800/ 54 621**.
- Ka mundësi për t' u regjistruar në listat "rezervë" në faqen www.QVAX.be



Dokument i realizuar dhe i përkthyer nga SetisW